

VENDIM
Nr. 219, datë 27.10.2021

**MBI SHTYRJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT, NË LIDHJE ME
PLOTËSIMIN E KUSHTEVE TË VENDIMIT NR. 110, DATË 26.4.2021, NGA
SHOQËRIA “BIOPOWER GREEN ENERGY” SHPK, VENDIMIT 111, DATË 26.4.2021,
NGA SHOQËRIA “E-VENTO SRL ALBANIA” SHPK, SI DHE VENDIMIT NR. 112,
DATË 26.4.2021, NGA SHOQËRIA “HERA” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 136/6 prot., datë 25.10.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi plotësimin e kushteve të vendimit nr. 110, datë 26.4.2021, nga shoqëria ‘Biopower Green Energy’ sh.p.k.; të vendimit nr. 111, datë 26.4.2021, nga shoqëria ‘E-Vento s.r.l. Albania’ sh.p.k. dhe të vendimit nr. 112, datë 26.4.2021, nga shoqëria ‘Hera’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimet nr. 110, nr. 111 dhe nr. 112, të datës 26.4.2021, ka vendosur që shoqëritë, përkatësisht “Biopower Green Energy” sh.p.k., “E-Vento s.r.l Albania” sh.p.k. dhe “Hera” sh.p.k., duhet të depozitonin në ERE, brenda 3 muajve nga botimi në Fletoren Zyrtare i këtyre vendimeve, dokumentacion në lidhje me plotësimin e kushteve të vendimeve të licencimit të këtyre shoqërive e po ashtu dokumentacionin ligjor vërtetues për realizimin e investimeve, në kuadër të zhvillimit të projekteve eolike.

- Në zbatim të këtyre vendimeve, shoqëritë kanë përcjellë në ERE informacion dhe dokumentacion brenda afatit.

- Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, rezultoi se shoqëritë kishin referuar se ishin në proces për t’u pajisur me dokumentacionet përkatëse nga organe të tjera shtetërore, siç janë bashkitë, në lidhje me dokumentet e pronësisë dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për lejen mjedisore etj., ndaj ERE iu drejtua organeve kompetente për të marrë një informacion të saktë se në cilën fazë ndodhet pajisja me këto dokumente apo leje.

- Pas marrjes së përgjigjes nga disa prej këtyre organeve, u depozitua dhe materiali përkatës, në lidhje me plotësimin nga ana e shoqërive të kushteve të vendosura në vendimet e Bordit nr. 110/2021, nr. 111/2021 dhe nr. 112/2021. Pas depozitimit të këtij materiali për shqyrtim, është përcjellë në ERE informacion dhe dokumentacion shtesë për sa kërkuar më herët nga ERE.

- Në mbështetje të nenit 67, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me qëllim shqyrtimin e këtij dokumentacioni, dhe zhvillimin e sancave të mundshme dëgjimore, vlerësohet e arsyeshme shtyrja me 30 ditë pune vendimmarrja e Bordit të ERE-s, në lidhje me plotësimin e kushteve të vendimeve të Bordit nr. 110, datë 26.4.2021, nr. 111, datë 26.4.2021 dhe nr. 112, datë 26.4.2021.

- Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen e Bordit të ERE-s, në lidhje me plotësimin e kushteve të vendimeve të Bordit nr. 110, datë 26.4.2021; nr. 111, datë 26.4.2021 dhe nr. 112, datë 26.4.2021.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti